



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 5 tetor 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Gani Geci, Ibrahim Makolli, Bajram Kosumi, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Kolë Berisha dhe Radmila Vujović.

Munguan: Mufera Şinik dhe Adem Hajdaraj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Elvan Noberdr dhe Sezi Aurely – Ambasada Turke dhe Enis Kervan – deputet.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

1. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, nr. 03/L-237.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së rendit të ditës.

1. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, nr. 03/L-237**

Kryetari - I njoftoi të pranishmit se për shkak të urgjencës ishte e nevojshme të mbahej kjo mbledhje, sepse ky Projektligj është radhitur si pikë e rendit të ditës në mbledhjen plenare. Për amendamentet e

Komisionit Funkcional nuk ka ndonjë vërejtje, me përjashtim për amendamentin 10, neni 14.1.5 i Projektligjit. Ky amendament është propozuar, sepse formularët për regjistrimin e popullsisë dhe të ekonomive familjare duhet të jenë në gjuhët zyrtare të Kosovës. Formulimi i propozuar nga Komisioni Funkcional i nënkupton edhe kërkesat e komuniteteve. Lidhur me këtë i ftoi anëtarët ta merrnin fjalën.

Ibrahim Makolli - Ligji për përdorimin e gjuhëve e specifikon qartë këtë çështje. Konsideroj se me këtë formulim nënkuptohet që edhe komunitetet t'i kenë formularët në gjuhën e tyre. Nëse do të thuhej vetëm "gjuhët në përdorim zyrtar", ndoshta do të kishte dilema, sepse me këtë mund të nënkuptohej edhe Kushtetuta. Meqë është thënë "Ligji për përdorimin e gjuhëve", qartësohet çështja.

Armend Zemaj - Ky Ligj bëhet për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. E dimë se regjistrimi i popullsisë nuk bëhet çdo vit, por një herë në dhjetë vjet. Prandaj Ligji për regjistrimin e popullsisë është i veçantë. Është me interes ta kemi një pasqyrë reale. Kjo mund të bëhet vetëm nëse i kemi edhe formularët në gjuhët e komuniteteve. Në amendamentin 10 duhet të përfshihet edhe thënia "nëpër komuna".

Selvi Halimi - Sipas arsytimit të sponzorizuesit të Ligjit ky është një projekt kombëtar. Për projekte kombëtare formularët plotësohen në gjuhët zyrtare të vendit. Në këtë rast turqishtja është gjuhë zyrtare vetëm në komunat ku ka turq mbi 5%, ashtu siç e përcakton edhe Ligji. Meqë është projekt kombëtar dhe vetëm në 2 - 3 komuna kemi numër më të madh të këtij komunitetit, në bazë të arsytimit të sponzorizuesit, të gjithë formularët do të duhej të mos plotësoheshin në nivel vendi, por të parashihej edhe një gjuhë që është zyrtare në nivel lokal. Ishte e mendimit që për një pasqyrim sa më real të gjendjes formularët do të duhej të ishin edhe në gjuhën turke.

Bajram Kosumi - Nëse mbetet formulimi "sipas gjuhëve zyrtare në Kosovë" nënkuptohet se gjuhë zyrtare janë dy. Kjo nuk e nënkupton edhe gjuhën turke. Po ashtu edhe nëse mbetet formulimi "konform ligjit për gjuhët zyrtare në Kosovë", përsëri nuk nënkuptohet gjuha turke, sepse në Kushtetutë dhe në ligj ka gjuhë zyrtare dhe gjuhë në përdorim zyrtar. Ishte i mendimit se po të mbetej formulimi "në gjuhët konform ligjit për përdorimin e gjuhëve" çështja do të ishte më e qartë.

Gani Geci - U pajtua që formularët e regjistrimit nëpër komuna të jenë në gjuhët e komuniteteve, sepse kështu do të kemi pasqyrë më reale për gjendjen e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Radmila Vujovic - I falënderoi të gjithë për diskutimet konstruktive për përdorimin e gjuhëve lidhur me propozimet e dhëna.

Enis Kervan - Ne kemi të dhëna se edhe buxheti është ndarë për gjuhën turke. Po ashtu nga Komisioni Evropian është dhënë drita e gjelbër, sepse të gjitha çështjet teknike janë përfunduar. Vetëm kjo çështje ka mbetur të rregullohet edhe me ligj. Ishte i mendimit që të përfshihen edhe fjalët "në gjuhët në përdorim nëpër komuna".

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

R E K O M A N D I M

Projektligji për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional bazën juridike e kanë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamentit 10, neni 14.1.5. i Projektligjit, që u rekomandua të rishikohet nga Komisioni Funksional.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni